



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.40, datë 15.11.2019**

**Për**

**miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

<b>1. Z. Ilir</b>	<b>Zela</b>	<b>Kryetar</b>
<b>2. Znj. Edlira</b>	<b>Dvorani</b>	<b>Anëtar</b>
<b>3 Znj. Ketrin</b>	<b>Topçiu</b>	<b>Anëtar</b>
<b>4. Znj. Xhoana</b>	<b>Lilaj</b>	<b>Anëtar</b>

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 15.11.2019 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Gërma q) e nenit 8 dhe pika 3 e nenit 79, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji 9918**);
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.378, datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
3. Udhëzues për Procedurat e Këshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

## K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,



- Dokumenti: “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”;
- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-akit miratues të dokumentit (projektvendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.378, datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, krahasuar me VKM nr. 546 datë 13.06.2013 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre” të shfuqizuar, përmban disa ndryshime, ku më kryesoret paraqiten më poshtë:
  - a. Sipas VKM nr. 546, AKEP verifikonte dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe nëse ai ishte sipas kërkesave të kësaj VKM-je, AKEP lëshonte konfirmim për njohjen e konformitetit të pajisjeve radio. Ndërsa sipas VKM nr. 378 vlerësimi i konformitetit do të bëhet nga një organ për vlerësimin e konformitetit për pajisjet radio, i akredituar nga Autoriteti miratues. Autoriteti miratues është Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike.
  - b. Sipas VKM nr. 546 AKEP lëshonte konfirmim për njohjen e konformitetit të pajisjeve radio, ndërsa sipas VKM nr. 378 AKEP bën regjistrimin e pajisjeve radio në një regjistër (database) të cilin e publikon online. Pas regjistrimit të pajisjes radio, AKEP lëshon një konfirmim regjistrimi.
  - c. Sipas VKM nr. 546, konfirmimi për njohjen e konformitetit bëhet për ato pajisje radio të cilat bënin pjesë në brezat e paharmonizuara të frekuencave, sipas CEPT, dmth që një brez nuk ishte i përcaktuar vetëm për një qëllim në Rajonin 1 të ITU (ku bën pjesë edhe Shqipëria), por përdorshin nga shtete të këtij Rajoni edhe për qëllime të ndryshme. Me miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave në vitin 2017 (VKM nr. 277 datë 29.03.2017), nuk ka më breza të paharmonizuara në Rajonin 1 të ITU. Sipas VKM nr. 378, AKEP bën vetëm regjistrimin e atyre pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3 të VKM nr. 378. Edhe në këtë rast vlerësimi i konformitetit, bëhet sërish nga organi vlerësues i konformitetit.
  - d. Në VKM nr. 546, AKEP-i ishte autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit, ndërsa me VKM nr. 378, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut (në vijim, ISHMT), dhe AKEP në bashkëpunim, marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisjet radio të mbuluara nga ky rregull, mund të vendosen në treg dhe në shërbim vetëm nëse janë në përputhje me këtë rregull teknik.
  - e. Në VKM nr. 546, Direktiva R&TTE kërkonte markimin CE në manualin e përdorimit. Sipas VKM nr. 378, markimi CE i konformitetit në pajisjen radio, vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në pajisje ose në pllakën e tij të dhënave. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së pajisjes radio, markimi vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese.
  - f. Sipas VKM nr. 546, produktet mund të përfitonin konformitetin dhe markimin CE për tregjet jo-Europiane, pa qenë të autorizuar për t’u përdorur në ndonjë vend të BE ose shteti me

markimin CE ndërsa sipas VKM nr. 378, pajisjet radio duhet të jenë në gjëndje të operojnë në të paktën një vend të Bashkimit Evropian; në qoftë se jo ai nuk mund të përfitojë markimin CE.

- g. Sipas VKM nr. 546, nuk kishte një listë të standardeve të harmonizuara, ndërsa VKM nr. 378 ka miratuar listën e standardeve të harmonizuara.
- h. Sipas VKM nr. 546, diapazoni frekuencor ishte 9 kHz deri 3000 GHz, ndërsa sipas VKM nr. 378, diapazoni frekuencor është zgjeruar, mbi 3000 GHz, pa kufizime në pjesën e poshtme, që do të thotë se tashmë 0 Hertz deri me 9 kHz është i përfshirë në qëllimin e RED.
- i. Sipas VKM nr. 546, kërkesa për njoftimin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian kërkohej për pajisjet e paharmonizuara të Klasës 2 dhe shenja CE shoqërohej me simbolin e alarmit , ndërsa sipas VKM nr. 378, në direktivën e re (RED) nuk do të këtë kërkesë për njoftimin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për pajisjet e paharmonizuara të Klasës 2. Si rrjedhojë simboli i alarmit  të Klasës 2 (rrethi me pikën çuditëse) është hequr gjithashtu nga kërkesat.
- j. Në VKM nr. 378, janë shtuar kërkesa të cilat nuk ekzistonin në VKM nr. 546, disa nga të cilat jepen më poshtë:
  - Detyrimi për të siguruar më shumë informacion kontakti për operatorin ekonomik.
  - Shtetet e Bashkimit Evropian do t'i kërkojnë operatorit ekonomik të përfshijë në të dhënat e pajisjes, adresën e website-it si dhe adresën fizike të vendndodhjes, me qëllim lehtësimin e komunikimit midis vendeve anëtare, autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve ekonomik dhe konsumatorëve.
  - Pajisja duhet të ketë numrin e identifikimit të produktit dhe informacionin e kontaktit për palën përgjegjëse. Çdo pajisje duhet të pajisjet me një emër të personit të kontaktit dhe udhëzime të vendosura në të ose në një dokumentacion bashkëlidhës, nëse ajo është një pajisje e vogël në përmasa.
  - Importuesit duhet të kenë të njëjtin informacion në pajisje ose mbi paketim; të gjithë operatorët ekonomik duhet të pranojnë përgjegjësinë ligjore për dhënien e saktë të informacionit të kontaktit.

2. Dokumenti për konsultim publik “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio” është hartuar në përputhje me VKM Nr. 378 datë 5.6.2019 dhe përcakton qartë të dhënat që do të përmbajë regjistri i pajisjeve radio që do të regjistrohen në AKEP, përmban konfiguracionin e numrit të regjistrimit, formularin e njoftimit për regjistrimin e pajisjeve radio dhe konfirmimin e njoftimit të regjistrimit.

Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, VKM Nr. 378 datë 5.6.2019 dhe në përputhje me Udhëzuesin e Proçedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1183 datë 10.03.2010, në kuadër të transparencës çmon si të arsyeshme nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, si për AKEP ashtu dhe për operatorët ekonomikë që do të fusin pajisje radio në treg dhe shërbime, bazuar në gërmën q) të nenit 8 dhe pikën 3 të nenit 79 Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM Nr. 378 datë 5.6.2019,

## **V E N D O S I:**

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit: “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”, të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Ilir Zela**

**ANËTAR**

**Edlira Dvorani**

**ANËTAR**

**Ketrin Topçiu**

**ANËTAR**

**Xhoana Lilaj**